

V E N D I M
Nr.560, datë 26.8.1996

PËR DHËNIE LEJE PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE

Në zbatim të nenit 44 dhe 65 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Të miratojë lejen për funksionimin e institucioneve arsimore private, si më poshtë:
 - a) Shkolla “Gjerasim Qiriazi” e nivelit të arsimit 8-vjeçar në qytetin e Tiranës. Ky institucion do të frekuentohet vetëm nga nxënës të huaj.
 - b) Kolegji turk “Turgut Ozal” i nivelit të arsimit 8-vjeçar dhe kolegji “Mehmet Akif Ersoy” i nivelit të arsimit të mesëm në qytetin e Tiranës.
 - c) Kolegji “Preka” i nivelit të arsimit të mesëm në qytetin e Korçës.
 - ç) Shkolla “Pjetër Mëshkalla” e nivelit të arsimit të mesëm në qytetin e Shkodrës.
 - d) Medresetë:
 1. “Mahmud Dashi”Tiranë
 2. “Ali Korça”Kavajë
 3. “Liria”Cërrik
 4. “Hoxha Tahsin”Gjirokastrë
 5. “H.Sheh Shamija”Shkodër
 2. Për medresetë e mëposhtme të miratojë lejen për funksionimin e tyre vetëm me nxënësit që janë regjistruar në to para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe deri në përfundimin e studimeve të këtyre nxënësve.
 1. “Mustafa Varoshi”Durrës
 2. “Vexhi Buharaja”Berat
 3. “Sulejman Laçi”Kukës
 4. “Raif Kadiu”Peshkopi
 5. “Medreseja e Korçës”Korçë
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sporteve të kontrollojë procesin mësimor laik dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën arsimore të këtyre institucioneve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi